



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3110/12 prot.

Datë 10.12.2024

V E N D I M
Nr. 1749/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.12.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1656/2024, datë 21.11.2024, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13597-07-18-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote” për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 46,713,446 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 465,644.40 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katë pikë dyzet) EURO pa tvsh, Loti II me nr. REF-13601-07-18-2024 me objekt: "Materiale Kancelarie të tjera zyre", me fond limit 6,426,931 (gjashtë milion e katërqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 64,064.30 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë) EURO pa tvsh, zhvilluar me datë 10-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK me NIPT K81503063B dhe adresë Njësia Bashkiake nr. 2, Rruga Faik Konica, ndërtesa nr. 3, hyrja nr. 7, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Blv.“Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datën 21.11.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1656/2024, ku vendosi:

- 1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës e paraqitur nga operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13597-07-18-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote” për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 46,713,446 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 465,644.40 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katë pikë dyzet) EURO pa tvsh, Loti II me nr. REF-13601-07-18-2024 me objekt: "Materiale Kancelarie të tjera zyre", me fond limit 6,426,931 (gjashtë milion e katerqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 64,064.30 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë) EURO pa tvsh, zhvilluar me datë 10-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.*
- 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” SHPK për procedurën e prokurimit të mësipërme.*
- 3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës dhe konstatimeve të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*

5. *Ngarkohet zyra e financës që të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "IT Gjergji Kompjuter" SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 894/40 prot., datë 04.12.2024, protokolluar me tonën nr. 3110/9 prot., datë 10.12.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1656/2024, datë 21.11.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-13597-07-18-2024, me objekt: "Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote" për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara", Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 46,713,446 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 465,644.40 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katë pikë dyzet) EURO pa tvsh, Loti II me nr. REF-13601-07-18-2024 me objekt: "Materiale Kancelarie të tjera zyre", me fond limit 6,426,931 (gjashtë milion e katerqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 64,064.30 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë) EURO pa tvsh, zhvilluar me datë 10-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara. Bashkëlidhur shkresës autoriteti kontraktor ka dorëzuar procesverbal rivlerësim të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 894/40 prot., datë 04.12.2024, protokolluar me tonën nr. 3110/9 prot., datë 10.12.2024, autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1656/2024, datë 21.11.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar", me Nr. REF-13597-07-18-2024, me objekt: "Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote" për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara", Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 46,713,446 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 465,644.40 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katë pikë dyzet) EURO pa tvsh, Loti II me nr. REF-13601-07-18-2024 me objekt: "Materiale Kancelarie të tjera zyre", me fond limit 6,426,931 (gjashtë milion e katerqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 64,064.30 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë) EURO pa tvsh, zhvilluar me datë 10-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara. Bashkëlidhur shkresës autoriteti kontraktor ka dorëzuar procesverbal rivlerësim të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

II.2. Referuar shkresës së dorëzuar nga autoriteti kontraktor me nr. 894/40 prot., datë 04.12.2024, rezulton, se autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1656/2024, datë 21.11.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik, Komisioni konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës së prokurimit sipas vendimit nr. 1656/2024, datë 21.11.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe ka pasqyruar vlerësimin në SPE.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, që autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 1656/2024, datë 21.11.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor, për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-13597-07-18-2024, me objekt: “Blerje materiale kancelarie e ndarë në 3 lote” për nevojat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve-Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, Fondi limit/vlera e pritshme e marrëveshjes kuadër: 46,713,446 (dyzet e gjashtë milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e gjashtë) Lekë pa TVSH ose 465,644.40 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e dyzet e katë pikë dyzet) EURO pa tvsh, Loti II me nr. REF-13601-07-18-2024 me objekt: "Materiale Kancelarie të tjera zyre"”, me fond limit 6,426,931 (gjashtë milion e katerqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) Lekë pa TVSH ose 64,064.30 (gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëdhjetë e katër pikë tridhjetë) EURO pa tvsh, zhvilluar me datë 10-09-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

